



UNIVERSITETI-UNIVERSITY
"UKSHIN HOTI"
PRIZREN

Zyra për Sigurimin e Cilësisë

Komisioni për Sigurimin e Cilësisë - Fakulteti Juridik



RAPORTI PËRMBLEDHËS I REZULTATEVE TË VLERËSIMIT PËR VITIN KALENDARIK 2025



www.uni-prizren.com



rektorati@uni-prizren.com



+383-29-232-140



Shkronjat Nr. 1 20000 Prizren

Anëtarët e Komisionit për Sigurimin e Cilësisë të Fakultetit Juridik:

Emri dhe mbiemri, koordinator

Prof. Asoc. Dr. Arif Riza



Emri dhe mbiemri, anëtar

Prof. Asoc. Dr. Armend Podvorica



Emri dhe mbiemri, anëtar

Ass. Alban Kryezi



Emri dhe mbiemri, anëtar

Enver Buzhala (Sekretar)



Emri dhe mbiemri, anëtar

Adrian Hoxha (Student)



Përmbajtja

1. Hyrje	4
2. A1 – Vlerësimi i mësimdhënësit nga studentët	5
3. A1.a – Vlerësimi i asistentit nga studentët.....	15
4. A2 - Vlerësimi ndërkolegial.....	23
5. A3 – Raporti i vlerësimit nga dekani	25
6. A4 – Vlerësimi për publikimet shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca	27
7. A5 – Raport i vlerësimit për kontributin në universitet dhe shoqëri	30
8. A6 – Vlerësimi gjithëpërfshirës	32
9. A7 – Pyetësor për vlerësimin e performancës së Dekanit.....	39
10. A8 – Vlerësimi nga studentët e diplomuar (para diplomimit)	43
11. A9 – Vlerësimi nga stafi akademik	49
12. A10 – Vlerësimi nga stafi administrativ	58
13. A11 – Vlerësimi nga Bordi Industrial Këshilldhënës.....	64
14. A12 – Pyetësor për monitorimin e braktisjeve	67
15. A13 – Vlerësimi ndërkolegial i orës mësimore	69
16. A14 – Vetëvlerësimi i mësimdhënësve.....	73
17. A15 – Plani i zhvillimit profesional të mësimdhënësit/asistentit.....	78
18. A16 – Gjurmimi i studentëve të diplomuar – ALUMNI	80
19. A17 – Vlerësimi i praktikës profesionale të studentëve.....	81
20. A18 – Vlerësimi i studentëve lidhur me Shërbimin e Këshillimit Akademik	82
21. A19 – Vlerësimi nga punëdhënësit	87

1. Hyrje

Zyra për Sigurim të Cilësisë vepron në kuadër të Administratës Qendrore të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren. ZSC-ja ka për qëllimin krijimin dhe avancimin e vazhdueshëm të politikave dhe praktikave të universitetit në funksion të ngritjes së cilësisë, në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Arsim të Lartë, Standardet e Sigurimit të Cilësisë në Zonën Evropiane, Standardet e Akreditimit/Agjencioni i Akreditimit të Kosovës dhe Rregulloren për Sigurim të Cilësisë.

Epror operativ i ZSC-së është Prorektori për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Ngritje të Cilësisë, ndërsa epror administrativ është Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit. Matja e cilësisë bëhet me instrumentet e përfshira në Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, të draftuara nga Komisioni Qendror i Sigurimit të Cilësisë dhe të miratuara në Senat. Raportet e hartuara nga Komisionet e Sigurimit të Cilësisë në nivel të njësive akademike duke përfshirë rekomandimet të cilat dalin nga rezultatet e vlerësimit, me hartimin e raportit përmbledhës, i dërgohen menaxhmentit me ç’rast njoftohen dekanët dhe udhëheqësit administrativ (palët e interesit) me qëllim të planifikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm dhe palët tjera të interesit. Raporti përmbledhës është publik, në uebfaqen e universitetit.

Lidhur me këtë raport, janë nxjerrë rezultatet nga pyetësorët të cilat parashihen në kuadër të Rregullorës për Sigurimin e Cilësisë.

Pyetësorë janë anonim dhe sigurojnë konfidencialitet të plotë.

Stafi akademik në kohë reale mund t’i shohin rezultatet e pyetësorit A1 (Pyetësor për vlerësimin e mësimit dhe asistentit) dhe A3 (Vlerësimi nga Dekani).

2. A1 – Vlerësimi i mësimdhënësit nga studentët

Pyetësi është i destinuar për studentët e nivelit baçelor. Pyetësi për mësimdhënësit përfshin 16 pyetje të mbyllura dhe një pyetje të hapur. Vlerësimi bëhet nga 1-5.

Pyetësi përfshin pyetjet lidhur me:


- Mësimdhënien,
- Raporti me studentë,
- Kodi etik.

Pyetësi është hartuar në mënyrë që të siguroj informacione rreth zbatimit të plotë të syllabusit, zhvillimi profesional, metodat e mësimdhënies, menaxhimi i kohës, kënaqshmëria në vlerësim, gadishmëria për ofrimin e konsultimeve, sjellja e mësimdhënësve/asistentëve.


Pyetësi realizohet dy herë në vit në fund të semestrit dhe është një ndër shtyllat e treguesit të performancës së stafit akademik. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit. Mësimdhënësit dhe asistentët njoftohen për performancën e tyre si dhe në kohë reale mund t'i shohin rezultatet e pyetësoreve në kohë reale në sistemin elektronike në profilin e tyre. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Rezultatet e pyetësit janë të kënaqshme me vlerësim 4.62 për semestrin veror dhe 4.64 në semestrin dimëror, nga vlerësimi i plotë pesë-shkallësh i performancës së stafit akademik.


Më poshtë janë paraqitur rezultatet për secilën pyetje në mënyrë grafike për vitin kalendarik 2025:




1. Në fillim të semestrit, mësuesi/ja ka prezantuar
syllabusin/përmbajtjen e lëndës dhe metodat e vlerësimit.




2. Mësuesi/ja ka qenë i rregullt në ligjërata.




3. Mësimdhënësi/ja ka shoqëruar ligjëratat me shembuj të cilat ndihmojnë në kuptimin e përmbajtjes së ligjëratës.




4. Mësimdhënësi/ja ka përdorur metoda dhe teknika të ndryshme për të bërë mësimdhënien më të kuptueshëm me studentin në qendër.




5. Mësimdhënësi/ja ka përdorur mjete të teknologjisë në mënyrë efektive gjatë ligjërimit




6. Mësimdhënësi/ja ka treguar gatishmëri për t'iu përgjigjur pyetjeve të studentëve dhe ka treguar kompetencë për lëndën.





7. Mësimdhënësi/ja gjatë ligjëratave ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë.




8. Mësimdhënësi/ja i jep rëndësi pjesëmarrjes aktive të studentëve në ligjërata.







11. Sa është harmonizuar përmbajtja e ligjëratave me ushtrimet? (nëse aplikohen ushtrimet)




12. Mësimdhënësi/ja e ka menaxhuar mirë kohën gjatë ligjëratave.




13. Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi.




14. Sa ka shprehur gatishmëri mësimmhënësi/ja në ofrimin e konsultimeve jashtë orarit të ligjëratarave?



15. Mësimdhënësi/ja është sjellur në përputhje me kodin etik.



16. Si e vlerësoni mësimdhënësin/en në përgjithësi?



Rekomandimet për programin “Juridik i Përgjithshëm (BSc)”:

- Të rritet përfshirja e shembujve praktikë dhe aktiviteteve interaktive në lëndët ku studentët kanë rekomanduar rritjen e interaktivitetit gjatë procesit mësimor.
- Të përdoren më tepër metodat interaktive gjatë procesit të mësimdhënies;
- Të promovohet përdorimi i mjeteve bashkëkohore teknologjike në procesin e ligjërimit;
- Të ruhet fokusi profesional i ligjëratarave, duke shmangur temat joakademike që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektivat e lëndës.

Rekomandimet për programin “Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit (LL.M)”:

- Të shqyrtohet mundësia që procesi i vlerësimit të lëndëve të realizohet nga studentët që kanë ndjekur rregullisht ligjëratat, me qëllim që rezultatet e vlerësimit të reflektojnë sa më objektivisht përvojën e studentëve në procesin mësimor.

3. A1.a – Vlerësimi i asistentit nga studentët

Pyetësi është i destinuar për studentët e nivelit baçelor. Pyetësi për asistentët përfshin katërbëdhjetë (14) të mbyllura dhe një (1) pyetje të hapur. Vlerësimi bëhet nga 1-5.

Pyetësi përfshin pyetjet lidhur me:


- Mësimdhënien,
- Raporti me studentë,
- Kodi etik.



Pyetësi është hartuar në mënyrë që të siguroj informacione rreth zbatimit të plotë të syllabusit, zhvillimi profesional, metodat e mësimdhënies, menaxhimi i kohës, kënaqshmëria në vlerësim, gadishmëria për ofrimin e konsultimeve, sjellja e mësimdhënësve/asistentëve.

Pyetësi realizohet dy herë në vit në fund të semestrit dhe është një ndër shtyllat e treguesit të performancës së stafit akademik. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit. Asistentët njoftohen në kohë reale për performancën e tyre. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.


Rezultatet e pyetësit janë të kënaqshme me vlerësim 4.64 për semestrin veror dhe 4.2 në semestrin dimëror, nga vlerësimi i plotë pesë-shkallësh i performancës së stafit akademik.

Më poshtë janë paraqitur rezultatet për secilën pyetje në mënyrë grafike për vitin kalendarik 2025:







3. Sa i është përmbajtur asistenti/ja syllabusit/përmbajtjes së lëndës?




4. Asistenti/ja ka përdorur metoda dhe teknika të ndryshme për të bërë mësimdhënien më të kuptueshëm me studentin në qendër.




5. Asistenti/ja ka përdorur mjete të teknologjisë në mënyrë efektive gjatë ligjërimit.




6. Asistenti/ja gjatë ushtrimeve ka inkurajuar diskutime dhe aktivitete në klasë.





7. Asistenti/ja i jep rëndësi pjesëmarrjes së studentëve në ushtrime.




8. Asistenti/ja ka përdorur burime të mjaftueshme në ushtrime.








11. Asistenti/ja e ka menaxhuar mirë kohën gjatë ushtrimeve.



12. Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi.





Rekomandimet për programin “Juridik i Përgjithshëm (BSc)”:

- Duke qenë se në disa lëndë asistentët nuk janë regjistruar në SMU, mësimdhënësit të kryejnë me kohë një regjistrim të tillë në lëndët për të cilat bëhet vlerësimi nga studentët.

Rekomandimet për programin “Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit (LL.M)”:

- Të respektohet orari i ushtrimeve në lëndë të caktuara.

4. A2 - Vlerësimi ndërkolegial

Pyetësi është i destinuar për stafin akademik. Vlerësimi ndërkolegial realizohet dy herë në vit dhe është një ndër kriteret e treguesit të performancës së stafit akademik. Pyetësi lansohet për të gjitha njësit akademike.




Pyetësi është i ndarë në 2 nivele të cilat vlerësohen nga 1-5.


- Bashkëpunimi dhe komunikimi kolegjial (5%), dhe
- Marrëdhëniet ndërpersonale dhe sjellja etike kolegjiale (5%).

Pyetësi ka për qëllim identifikimin e përparësive dhe nevojave për përmirësim në marrëdhëniet ndërkolegjiale. Mësimdhënësit njoftohen për performancën e tyre çdo semestër përfshirë edhe vlerësimin ndërkolegjial. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Më poshtë janë paraqitur rezultatet në mënyrë grafike lidhur me vlerësimin ndërkolegjial:

- Bashkëpunimi dhe komunikimi kolegjial: 4.27%;
- Marrëdhëniet ndërpersonale dhe sjellja etike kolegjiale: 4.23%
- Vlerësimi ndërkolegjial: 8.5%





Rekomandimet:

- Derisa pyetësi për vlerësimin ndërkolegial të mbetet në përdorim si instrument i sigurimit të cilësisë, të respektohet objektiviteti dhe profesionalizmi në vlerësimin ndërmjet kolegëve.
- Të shqyrtohet mundësia e largimit të këtij pyetësi për vlerësimin ndërkolegial si një nga instrumentet për sigurimin e cilësisë.

5. A3 – Raporti i vlerësimit nga dekani

Pyetësi është i destinuar për Dekanët për vlerësimin e stafit akademik të njësive akademike dhe realizohet dy herë brenda vitit dhe është një ndër shtyllat që përcaktojnë performancën e stafit akademik.

Pyetësi është ndarë në 4 shtylla/kategori për vlerësim, si dhe një pyetje të hapur me ç’rast vlerësohet:

- Kontributi për fakultetin (pjesëmarrja në mekanizma dhe komisione përkatëse të njësisë akademike) (5%),
- Përbushja e obligimeve kontraktore, mësimdhënia/mbajtja e provimeve (5%)
- Puna vullnetare dhe angazhimi në aktivitete jashtëkurikulare brenda fakultetit (5%)



Qëllimi i pyetësorit është vlerësimi nga Udhëheqësi i njësisë akademike me qëllim të sigurimit të informacioneve për përmirësim.



Mësimdhënësit në kohë reale njoftohen për vlerësimi e tyre nga Dekani në sistemin elektronik/profilin e tyre.

Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësit.

Rezultatet e vlerësimit të dekanit për stafin akademik për vitin kalendarik 2025 janë paraqitur në mënyrë grafike si më poshtë:





Rekomandimet:

- Të ruhet niveli i lartë i angazhimit të stafit akademik në aktivitetet institucionale, përmes pjesëmarrjes në komisione, përmbushjes së obligimeve mësimore dhe përfshirjes në aktivitete jashtëkurikulare.

6. A4 – Vlerësimi për publikimet shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca

Pyetësi është i destinuar për stafin e rregullt akademik me qëllim të evidentimit të arritshmërisë, së stafit në:

- Publikimin e punimeve shkencore (publikimi i së paku 1 (një) punimi shkencor në platformat sipas UA-së, MASHTI 01/2018 mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare si Web of Science ose Scopus që vlerësohet me 30%.
- Publikimi në së paku 1 (një) punimi shkencor në platformat sipas UA-së, MASHTI 01/2018 mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare si EBSCO, World Cat, DOAJ që vlerësohet me 15%.
- Pjesëmarrje/publikime në konferencë, kongresë dhe punëtori ndërkombëtare akumulon nivelin e vlerësimit në shkallën (10%).
- Pjesëmarrje/publikime në konferencë, kongresë dhe punëtori kombëtare akumulon nivelin e vlerësimit në shkallën (5%).






Vlerësimi bazohet në prova faktike. Pyetësi realizohet një herë në vit dhe është një nga shtyllat që përcaktojnë performancën e stafit akademik.

Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga rezultatet e vlerësimit. Universiteti synon që rezultatet të jenë të matshme me qëllim të sigurimit të cilësisë në universitet. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Në nivel universiteti, publikimi i së paku 1 (një) punimi shkencor në platformat sipas UA-së, MASHTI 01/2018 mbi parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare si Web of Science ose Scopus që vlerësohet me 30%.

Lidhur me publikimin e punimeve shkencore dhe pjesëmarrjes së stafit në konferenca apo kongrese ndërkombëtare dhe kombëtare në nivel fakulteti, rezultatet janë si në vijim:

- Nëntë (9) mësimitdhënës nga njëmbëdhjetë (11) të deklaruar, kanë të publikuar punime shkencore në revista të indeksuar në Web of Science ose Scopus;
- Nëntë (9) mësimitdhënës nga njëmbëdhjetë (11) të deklaruar, kanë të publikuar punime shkencore në revista të indeksuar në EBSCO, World Cat dhe DOAJ;
- Dhjetë (10) mësimitdhënës nga njëmbëdhjetë (11) të deklaruar, kanë marrë pjesë apo kanë të publikuar punim në konferencë, kongres dhe punëtori ndërkombëtare;
- Nëntë (9) mësimitdhënës nga njëmbëdhjetë (11) të deklaruar, kanë marrë pjesë apo kanë të publikuar punim në konferencë, kongres dhe punëtori rajonale/kombëtare.

Rezultati lidhur me numrin e publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca apo kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare të stafit akademik për vitin kalendarik 2025, është paraqitur në mënyrë grafike si më poshtë:



Rekomandimet:

- Stafi akademik të angazohet edhe më tepër në rritjen e numrit të publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në kongrese apo konferenca.
- Të rritet numri i publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjes në konferenca/kongrese në bashkëpunim me studentët.

7. A5 – Raport i vlerësimit për kontributin në universitet dhe shoqëri


Pyetësi është i destinuar për stafin e rregullt akademik me qëllim të nxitjes së stafit në pjesëmarrje në komisione, grupe punuese, grupe të ekspertëve të universitetit si dhe pjesëmarrje aktive në aktivitetet e komunitetit (punë vullnetare, punëtori, ekspertiza etj.).




- Kontributi aktiv në më shumë se një komision, grup punues vlerësohet me 15%.
- Kontributi aktiv në së paku një komision, grup punues vlerësohet me 10%.
- Pjesëmarrja aktive në së paku një aktivitet të komunitetit (punë vullnetare, punëtori, ekspertiza vlerësohet 10%

Pyetësi realizohet një herë në vit për stafin e rregullt akademik dhe është një ndër shtyllat që përcaktojnë performancën e stafit akademik. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Universiteti synon që rezultatet të jenë të matshme me qëllim të sigurimit të cilësisë në universitet.

Lidhur me kontributin e stafit në universitet dhe shoqëri përmes pjesëmarrjes në komisione, grupe punuese, grupe të ekspertëve të universitetit, si dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e komunitetit në nivel fakulteti, rezultatet janë si në vijim:

- Njëmbëdhjetë (11) mesimdhënës nga njëmbëdhjetë (11) të deklaruar, kanë marrë pjesë aktivisht në së paku një (1) komision punues apo grup të ekspertëve të Universitetit;
- Dhjetë (10) mesimdhënës nga njëmbëdhjetë (11) të deklaruar, kanë marrë pjesë aktivisht në më shumë se një (1) komision punues apo grup të ekspertëve të Universitetit;
- Dhjetë (10) mesimdhënës nga njëmbëdhjetë (11) të deklaruar, kanë marrë pjesë aktivisht në së paku një (1) aktivitet të komunitetit (punë vullnetare, punëtori, ekspertiza të ndryshme)





Rekomandimet:

- Stafit akademik të ruajë angazhimin dhe kontributin aktiv në komisione ose grupe punuese në Universitet, apo edhe në aktivitete të komunitetit.
- Të dhënat mbi kontributet e tilla të stafit akademik të jenë të plota dhe të verifikueshme për një vlersim objektiv të performancës.

8. A6 – Vlerësimi gjithëpërfshirës

Pyetëtori është i destinuar për studentët. Vlerësimi gjithëpërfshirës është hartuar me qëllim që të siguroj një informacion gjithëpërfshirës nga studentët. Pyetëtori realizohet një (1) herë në vit dhe është i ndarë në 4 shtylla/kategori për vlerësim me 31 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura.

- Kategoria e programit studimor përmban 7 pyetje,
- Kategoria e fakultetit, qeverisjes dhe shërbimeve për studentë përmban 7 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur,
- Kategoria për shërbimet administrative të universitetit përmban 3 pyetje,
- Kategoria e bibliotekës përmban 7 pyetje,
- Kategoria e infrastrukturës përmban 4 pyetje,
- Kategoria e aktiviteteve jashtë kurrikulare përmban 4 pyetje.

Pyetjet kanë qëllim të ofrojnë outpute në aspektet:





- Sa i përmbush programi studimor pritshmëritë e studentëve,
- Mjaftueshmërinë e lëndëve zgjedhore,
- Motivimin për punë kërkimore shkencore të studentëve,
- Programi studimor dhe punësimi,
- Korrelacioni menaxhment-student,
- Funkcionaliteti i fakulteteve, shërbimeve studentore,
- Raportet ndërpersonale,
- Zgjedhjet studentore,
- Mobiliteti,
- Informimi, shërbimet e IT-së,
- Biblioteka, qasja, literatura, shërbimi,
- Infrastruktura, sallat, kabinetet, paisjet laboratorike, higjiena.

Vlerësimi bëhet nga 1-5. Pyetëtori është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetëtorët.


Mesatarja totale: 4.2%

Numri i responentëve: 288


Rezultati lidhur me vlerësimin gjithëpërfshirës për vitin kalendarik 2025, është paraqitur në mënyrë grafike si më poshtë:




5. Studentëve u ofrohen shërbime dhe këshilla nga bartësit e programit studimor.




6. Menaxhmenti i fakultetit (dekani, prodekani, shefi i programit) është i hapur për vërejtje, sugjerime dhe kërkesa të studentëve.




7. Fakulteti ka staf të mjaftueshëm dhe funksionon në mënyrë efikase.




8. Shërbimi i Këshillimit Akademik në fakultet ndihmon studentët që kanë nevojë




Shërbimi i Këshillimit Akademik në fakultet ndihmon studentët që kanë nevojë




9. Shërbimi studentor në fakultet është i kënaqshëm.




10. Fakulteti ofron kushte infrastrukturore të kënaqshme (p.sh. ndërtesa, klasa, laboratore, hapësira sociale).




11. Raportet mësimdhënës-student janë miqësore dhe motivuese.




12. Studentët marrin pjesë në zgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve të Parlamentit Studentor (PS).




13. Studentëve i ofrohen mundësi për mobilitet dhe intership jashtë vendit (p.sh. Erasmus).




14. Administrata ofron shërbime efikase për studentët.




15. Shpalljet dhe njoftimet për studentë jepen me kohë.




16. Personeli i IT-së ofron shërbime efikase për studentët.




17. Biblioteka ka personel të mjaftueshëm dhe profesional.




18. Biblioteka punon me orar të përshtatshëm për studentët.




19. Biblioteka është e pasur me literaturë të mjaftueshme.




20. Biblioteka ofron qasje të mjaftueshme dhe efikase në bibliotekat elektronike.




21. Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme në gjuhët e komuniteteve (boshnjakisht, turqisht).




22. Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme në gjuhët e huaja. (anglisht, gjermanisht).




23. Biblioteka ofron qasje dhe shërbime të kënaqshme për personat me nevoja të veçanta.




24. Në Fakultet/Universitet ka hapësira të mjaftueshme.




25. Sallat e mësimit ofrojnë kushte të kënaqshme për mësim.







26. Mirëmbajtja e hapësirave të Fakultetit/Universitetit është në nivelin e duhur.



27. Kabinetet e informatikës janë të pajisura me kompjuterë dhe IT pajisje dhe të njëjtat janë në dispozicion për studentët.





Rekomandimet:

- Studentët të njoftohen më shumë rreth mobiliteteve me programin Erasmus;
- Të pajisen klasat dhe sallat e ligjëratave me materialet dhe pajisjet bazë të nevojshme për mësimdhënie efektive.

9. A7 – Pyetësor për vlerësimin e performancës së Dekanit





Pyetësori është i destinuar për stafin akademik me ç'rast vlerësohet dekani i njësisë përkatëse akademike. Vlerësimi i performancës së dekanit nga ana e stafit akademik realizohet një herë në vit. Pyetësori përmban 18 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur.

Qëllimi i pyetësorit është vlerësimi i aspekteve të performancës së Dekanit si:


- Vizioni dhe zhvillimi i njësisë akademike;
- Qeverisja dhe vendimmarrja;
- Motivimi dhe mbështetja në punë kërkimore-shkencore;
- Diskutimet në kuadër të njësisë akademike;
- Aftësitë e përfaqësimit brenda dhe jashtë universitetit;

Pyetësori është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Vlerësimi bëhet nga 1-5. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandimet që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësorët.


Pyetësorit i janë përgjigjur 8 respondentë në nivel fakulteti, rezultatet e të cilit janë paraqitur në mënyrë grafike, si më poshtë:




3. Punon dhe komunikon në mënyrë efektive me dekanë, stafin akademik dhe stafin administrativ.




4. Përkrah në mënyrë efektive nevojat e fakultetit duke marrë parasysh gjithashtu nevojat më të gjera të universitetit.




5. Promovon një atmosferë të favorshme për zhvillimin e fakultetit.




6. Është motivues dhe mbështetës në lidhje me punën kërkimore-shkencore.




7. Ofron mbështetje për zhvillimin dhe rritjen e programit.




8. Merr iniciativa për hapjen e programeve të reja.




9. Përfaqëson dhe mban kontakte me komunitetin e jashtëm.




10. Mbron integritetin akademik.




11. Shfaq dhe inkurajon standarde të larta etike.




12. Shfaq gatishmëri për të marrë vendime dhe për të përfshirë njerëzit e duhur në proces.






13. Është lehtë i qasshëm dhe komunikon hapur me fakultetin.



14. Punon me shefat për mësim/bartësit e programeve për të lehtësuar rrjedhën e informacionit.





Rekomandimet:

- Nuk ka.

10. A8 – Vlerësimi nga studentët e diplomuar (para diplomimit)

Pyetësi përdoret nga studentët e diplomuar në nivelin baçelor dhe master, për secilin program studimor. Pyetësi përmban 24 pyetje, 22 prej të cilave janë të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura.



Pyetësi është i ndarë në tri shtylla/kategori:

- Programi studimor,
- Mësimdhënia dhe vlerësimi,
- Trajtimi i studentëve dhe mbështetja e mësimit.


Qëllimi i pyetësit është të mbledh informacione lidhur me përmbajtjen e programit, koherencën e programit ndër vite, pritshmëritë, mësimdhënien, ushtrimet, punën praktike, përfshirjen e studentëve në punë kërkimore, mobilitetin, vlerësimin, afatet e provimeve, raportet mësimdhënësstudent, konsultimet, mentorimin, zyrën për karrierë dhe alumni, përgatitjen profesionale gjatë studimeve, ECTS-të, pritjet nga programi, dobësitë, pikat e forta etj.

Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe komentet e studentëve lidhur me pikat e forta, dobësit dhe sugjerimet për përmirësim me qëllim të përmirësimit të cilësisë së përgjithshme të programit të studimit.


Pyetësit i janë përgjigjur dyzet e shtatë (47) responentë, ku mesatarja e vlerësimit të programit studimor nga absolventët është 4.71% nga vlerësimi i përgjithshëm prej 5%.




1. Si e vlerësoni përmbajtjen dhe cilësinë e lëndëve të programit?




2. Si e vlerësoni shpërndarjen e ngarkesës së lëndëve gjatë semestrit?




3. Sa e vlerësoni përputhjen e ngarkesës së punës së studentit me ECTS-të e lëndëve?




4. Sa ka kontribuar literatura në dispozicion në arritjen e rezultateve të nxënit?




5. Si e vlerësoni punën praktike dhe mundësinë për të zhvilluar njohuritë e fituara teorike në praktikë?




6. Sa i ka përmbushur pritjet e juaja programi studimor?




7. Në çfarë mase ka arritur programi i studimit të ju përgatis për punë?




8. Përgjithësisht, si e vlerësoni programin e studimit në të cilin keni diplomuar?




9. Në çfarë mase ju ka përgatitur programi i studimit për të vazhduar studimet në të njëjtën fushë?




10. Duke marrë parasysh përvojat tuaja, a do t'ua rekomandonit programin tuaj të studimit të tjerëve?




11. A planifikoni të regjistrohni në ndonjë program pasuniversitar të studimit (Master apo Doktoratë) në të ardhmen?




12. Si e vlerësoni organizimin e punës praktike jashtë fakultetit?




13. Si e vlerësoni pjesëmarrjen në punën në terren (nëse ka)?




14. Si e vlerësoni përfshirjen tuaj në projektet kërkimore me mësimdhënësit?




15. Si i vlerësoni mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar/mobilitet?




16. Si i vlerësoni kriteret e vlerësimit për kalimin me sukses të lëndës?




18. Si i vlerësoni format e tjera të vlerësimit (kolokviume, projekte punime seminarike, etj.)?



19. Si e vlerësoni qasjen e stafit mësimdhënës?





Komentet e studentëve për programet studimore

Pikat e forta të programit “Juridik i Përgjithshëm (BSc)”:

- Programi i studimit juridik ofron një bazë të fortë teorike dhe praktike, duke përfshirë lëndë kyçe si e drejta kushtetuese, administrative, penale dhe ndërkombëtare. Ai është i përshtatur me nevojat e tregut të punës, duke hapur mundësi për karriera në avokati, gjyqësor, administratë publike dhe sektorin privat.
- Lëndët ndërkombëtare.

Pikat e dobëta të programit “Juridik i Përgjithshëm (BSc)”:

- Metoat e vlerësimit duhet të jenë të bazuara në vlerësimin e vazhdueshëm dhe të jenë në përputhje me sylabusin dhe rezultatet e të nxëniet të lëndës përkatëse.
- Programi i studimit juridik, ndonëse ofron një bazë të mirë teorike, ka disa dobësi që mund të ndikojnë në përgatitjen e plotë të studentëve. Mungesa e praktikave të detyrueshme dhe

e lidhjeve më të forta me institucionet juridike kufizon përvojën praktike të studentëve. Për më tepër, disa lëndë mund të jenë të mbingarkuara me teori, duke lënë më pak hapësirë për aplikimin praktik të njohurive. Përveç kësaj, ka nevojë për më shumë projekte praktike dhe bashkëpunime me organizata joqeveritare që veprojnë në fushën e drejtësisë, në mënyrë që studentët të kenë një ekspozim më të madh ndaj rasteve reale dhe sfidave juridike.

Rekomandimet për programin “Juridik i Përgjithshëm (BSc)”:

- Të sigurohet që metodat e vlerësimit të jenë të bazuara në vlerësim të vazhdueshëm dhe në përputhje me sylabuset dhe rezultatet e të nxënit.
- Të integrohen praktika të detyrueshme për të forcuar përvojën praktike të studentëve.
- Të forcohet bashkëpunimi me institucionet juridike dhe organizatat relevante, për të mundësuar përfshirjen më të madhe të studentëve në aktivitete praktike dhe raste reale.
- Të balancohet përmbajtja teorike me më shumë fokus në aplikimin praktik dhe projekte praktike.

Pikat e forta/të dobëta të programit “Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit (LL.M)”:

- Për këtë program studimi nuk janë paraqitur pika të forta dhe të dobëta, për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme për vlerësim

Rekomandimet për programin “Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit (LL.M)”:

- Për shkak të mungesës së të dhënave, në këtë fazë të vlerësimit nuk mund të jepen rekomandimet e nevojshme lidhur me këtë program studimor.

11. A9 – Vlerësimi nga stafi akademik

Pyetësi përdoret nga stafi akademik i universitetit dhe realizohet një herë në vit.



Pyetësi përmban 43 pyetje, prej të cilave 1 pyetje është e hapur.

Pyetësi është i ndarë në tri shtylla/kategori:


- Menaxhimi dhe pjesëmarrja;
- Puna kërkimore – shkencore;
- Infrastruktura

Qëllimi i pyetësit është të siguroj informacione rreth institucionalizimit, transparencës në universitet, pjesëmarrjes në vendimarrje, kriteret dhe promovimin akademik, përpjekjet për inovacion, sigurim të cilësisë, misionin dhe vizionin e universitetit, objektivat strategjike, ndërkombëtarizimin, avancimin profesional, numrin e studentëve, syllabuset, ECTS-të, mobilitetin, drejtuesit e njësive akademike, komunikimin staf akademik/student/staf administrativ, shërbimet e bibliotekës, bashkëpunimin për punë kërkimore – shkencore, trajnimet, projektet, aktivitetet jashtë kurikulare, infrastrukturën, higjienën, shërbimet IT, mjetet e komunikimit, web faqen etj. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.


Pyetësit i janë përgjigjur nëntë (9) responentë në nivel fakulteti, me ç'rast është siguruar një mesatare totale të vlerësimit prej 3.63% nga vlerësimi i përgjithshëm prej 5%.




1. Si e vlerësoni transparencën dhe përgjegjshmërinë e vendimeve të Senatit dhe Këshillit Drejtues të Universitetit?




2. Si e vlerësoni transparencën dhe përgjegjshmërinë e vendimeve të Këshillit të Fakultetit dhe Dekanatit?




3. Si e vlerësoni lirinë e të shprehurit?




4. Si i vlerësoni angazhimin e institucionit për inovacion, ndryshim dhe përmirësim të cilësisë?




5. Si e vlerësoni përcaktimin e objektivave dhe performancës së njësisë akademike?




6. Si e vlerësoni misionin dhe vizionin e Universitetit? Nëse vlerësimi është 1 ose 2 shënoni arsyen!




7. Si e vlerësoni misionin dhe vizionin e Fakultetit?




8. Si i vlerësoni prioritetet dhe objektivat strategjike të Universitetit? Nëse vlerësimi është 1 ose 2 shënoni arsyen!




9. Si i vlerësoni prioritetet dhe objektivat strategjike të Universitetit?




10. Si i vlerësoni prioritetet dhe objektivat strategjike të Fakultetit?




11. Si i vlerësoni marrëdhëniet e Universitetit me institucionet e jashtme (institucionet publike, private, OJQ-të, publikun...)?




12. Si e vlerësoni mundësinë e avancimit akademik/profesional dhe kompensimin tuaj financiar?




13. Si e vlerësoni numrin e studentëve në programin tuaj studimor? Nëse vlerësimi është 1 ose 2 shënoni arsyen




14. Si e vlerësoni përputhshmërinë e programit, përmbajtjes e lëndëve me kredi -ECTS? Nëse vlerësimi është 1 ose 2 shënoni arsyen!




15. Si e vlerësoni numrin e stafit akademik në fakultetin tuaj?




16. Si e vlerësoni interesimin e studentëve të huaj për studime në Fakultet?




17. Si e vlerësoni qasjen tek drejtuesit e njësive akademike (dekani, prodekani, shefi i programit)?




18. Si e vlerësoni qasjen tek menaxhmenti i lartë i Universitetit (Rektori, Prorektorët)?




19. Si e vlerësoni komunikimin tuaj me stafin administrativ në fakultet?




20. Si e vlerësoni shërbimin e bibliotekës me libra, revista, dokumente hulumtuese, baza të të dhënave, e-bibliotekë?




21. Si e vlerësoni bashkëpunimin në mes stafit akademik në punën kërkimore-shkencore?




22. Si i vlerësoni politikat dhe masat nxitëse për punë kërkimore-shkencore në Universitet?




23. Si e vlerësoni përkrahjen e Universitetit \Fakultetit, për pjesëmarrje në kongrese, konferenca dhe punëtori ndërkombëtare?




24. Si e vlerësoni QPM-në lidhur me trajnimet e mësimdhënësve?




25. Si e vlerësoni përkrahjen e Universitetit në hartimin dhe dizajnimin e projekteve kërkimore shkencore?




26. Si e vlerësoni zbatimin dhe përkrahjen e projekteve nga jashtë në punën kërkimore?




27. Si e vlerësoni mjaftueshmërinë e programeve të mobilitetit (Erasmus+ etj.)?




28. Si i vlerësoni kushtet për aktivitete kulturore dhe artistike në Universitet?




29. Si i vlerësoni aktivitetet sportive dhe hapësirat e krijuara për këtë qëllim?




30. Si e vlerësoni higjienën në kampus në përgjithësi?




31. Si i vlerësoni masat e sigurisë (zjarri ...)?




32. Si i vlerësoni shërbimet lidhur me transportin për qëllime akademike?




33. Si i vlerësoni shërbimet e bufesë?




34. Si i vlerësoni shërbimet e internetit, përpunimit të informacionit?




35. Si e vlerësoni përmbajtjen dhe dizajnin e uebfaqes së Universitetit?




36. Si e vlerësoni përmbajtjen e faqes së Fakultet në internet?




37. Si i vlerësoni pajisjet në klasa (kompjuter, projektor, tabelë e mençur)?




38. Si i vlerësoni kapacitetet e laboratorëve?




39. Si e vlerësoni kapacitetet e sallave të mbledhjeve dhe konferencave?




40. Si e vlerësoni mjaftueshmërinë e pajisjeve në zyrë (kompjuter, printer, inventar)?



41. Si e vlerësoni mjaftueshmërinë e personelit administrativ dhe personelit ndihmës në Universitet dhe Fakultet?



42. Në çfarë mase përputhen pritshmëritë tuaja me gjendjen aktuale në Fakultet?



Rekomandimet:

- Të rriten mundësitë për avancim akademik dhe profesional të stafit akademik, si dhe të rishikohet kompensimi financiar, me qëllim përmirësimin e motivimit dhe angazhimit të stafit.
- Të forcohen masat për tërheqjen e studentëve të huaj, përmes promovimit të programeve akademike të fakultetit, bashkëpunimeve ndërkombëtare, apo edhe shkëmbimeve studentore.
- Të përmirësohen politikat dhe masat nxitëse për punë kërkimore shkencore, përmes financimit të projekteve kërkimore, të publikimeve shkencore, si dhe mbështetjes për udhëtime dhe pjesëmarrje në kongrese apo konferenca ndërkombëtare.
- Të shqyrtohet mundësia për mbështetje financiare edhe të studentëve në punën e tyre hulumtuese si bashkëautorë të punimeve shkencore apo pjesëmarrjes në konferenca/kongrese shkencore me profesorë.





12. A10 – Vlerësimi nga stafi administrativ

Pyetësi është i destinuar për stafin administrativ në nivel qendror dhe në njësi akademike. Pyetësi realizohet një herë në vit.


Pyetësi përmban 27 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur. Qëllimi i pyetësit është identifikimi i dobësive dhe mangësive me qëllim të përmirësimit si në nivel qendror, poashtu edhe në nivel të njësive akademike.

Pyetësi ka për qëllim vlerësimin e institucionalizimit të universitetit, transparencën, përgjegjshmërinë, mundësitë për vendimmarrje, detyrat/kompetencat, bashkëpunimin me staf administrativ, akademik, studentë, avancimin, ambientet e punës, lirinë e të shprehurit, përpjekjet për sigurim të cilësisë, ndërkombëtarizimin, menaxhmentin, infrastrukturën, sigurinë, shërbimet e bifesë, shërbimet e informimit/komunikimit, webfaqen, pritshmëritë etj.


Rezultatet e pyetësit janë paraqitur si në vijim:




3. Si e vlerësoni shpërndarjen e detyrave, kompetencave dhe përgjegjësiive?




4. A vlerësoni që ekziston përshkrim i qartë i detyrave të punës?




5. Si e vlerësoni harmoninë\bashkëpunimin në mes të stafit administrativ?




6. Si i vlerësoni kriteret e përzgjedhjes dhe procedurat e promovimit administrativ?




7. Si e vlerësoni sigurinë e ambientit të punës?




8. Si e vlerësoni organizimin e trajnimeve për staf administrativ?




9. Si e vlerësoni numrin e personelit administrativ dhe ndihmës në Universitet?




10. Si e vlerësoni lirinë e të shprehurit?




11. Si i vlerësoni përpjekjet për sigurimin e cilësisë në Universitet\Fakultet?




12. Si e vlerësoni transparencën në sistemin e përzgjedhjes së punëtorit më të mirë administrativ?




13. Si e vlerësoni misionin dhe vizionin e Universitetit/Fakultet?




14. Si i vlerësoni prioritetet dhe objektivat strategjike të Universitetit/Fakultet?




15. Si e vlerësoni bashkëpunimin e stafit akademik në raport me administratën?




16. Si e vlerësoni qasjen te drejtuesit të njësive akademike (dekani, prodekani, shefi i programit)?




17. Si e vlerësoni qasjen te menaxhmenti i lartë i Universitetit (Rektori, Prorektorët)?




18. Si i vlerësoni mundësitë e diskutimit dhe zgjidhjen e problemeve në punë me eprorët?




19. Si e vlerësoni higjienën në objekte dhe zyrë?




20. Si e vlerësoni infrastrukturën në Universitet \Fakultet?




21. Si i vlerësoni masat e sigurisë (zjarri, masat tjera të sigurisë...)?




22. Si i vlerësoni shërbimet e bufesë?




23. Si i vlerësoni shërbimet e internetit, shpërndarjes së informacionit?




24. Si e vlerësoni përmbajtjen dhe dizajnin e uebfaqes së Universitetit?




25. Si i vlerësoni mjaftueshmërinë e pajisjeve në zyrë (kompjuter, printer, inventar)?



26. Në çfarë mase përputhen pritshmëritë tuaja për zhvillimin në karrierë-avancim?





Rekomandimet:




- Nuk ka.

13. A11 – Vlerësimi nga Bordi Industrial Këshilldhënës


Pyetësi është i destinuar për punëdhënësit gjegjësisht BKI-të dhe realizohet një herë në vit.

Pyetësi përbëhet nga 8 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje të hapur. Qëllimi i pyetësit është rritja e bashkëpunimit me sektorin e biznesit, vlerësimi i bashkëpunimit me universitet / njësitë akademike, përgatitjen e studentëve për industri, kontributi i BKI-së në universitet dhe vice versa. Pyetësi është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.


Pyetësit i janë përgjigjur 3 respondentë, ku nga vlerësimi i përgjithshëm prej 5%, Fakulteti Juridik është vlerësuar me një mesatare prej 4.33%.




3. Sa mendoni se njësia akademike është efektive në përgatitjen e studentëve për karrierë në industrinë tuaj?




4. Si e vlerësoni ndërveprimin me stafin akademik të fakultetit?




5. Si i vlerësoni kontributet e njësisë akademike për kompaninë tuaj (ekspertizë, këshillim)?




6. Bordet Këshillëdhënëse Industriale e kuptojnë nevojën e bashkëpunimit reciprok me universitetin/fakultetin.



7. Sa jeni të kënaqur me ofrimin e punës praktike nga ana e BKI-së për studentët e njësisë akademike?



8. Në çfarë mase e vlerësoni kontributin tuaj në përkrahjen financiare të studentëve, si bursa/projekte hulumtuese?



Rekomandimet:

- Të ndërmerren masa për rritjen e numrit të respondentëve në pyetësorin e vlerësimit nga BKI.

14. A12 – Pyetësor për monitorimin e braktisjeve


Pyetësori është i destinuar për studentët të cilët ç’regjistrohen në nivelet baçelor dhe master, në të gjitha programet studimore. Pyetësori realizohet gjatë fazës së ç’regjistrimit të studentit me qëllim të mbledhjes së informacioneve për arsyet e tërheqjes nga studimet dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe parandalimit të tërheqjes së studentëve nga studimet.

Pyetësori është i ndarë në tre kategori dhe nënkategori:

- Arsye personale;
- Migrimi;
- Arsye në lidhje me programin/lëndën/fakultetin;
- Mungesa e studimeve me korespondencë;
- Ndërrim i fakultetit;
- Punësimi;
- Arsye financiare;
- Studime jashtë shtetit, si dhe;
- Të tjera

Pyetësori po ashtu përfshin edhe dy pyetje të hapura. Pyetësori është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë. Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe arsyet e braktisjes.

Rezultatet lidhur me monitorimin e braktisjes së studimeve të plotësuar nga studentët në nivel fakulteti, janë paraqitur më poshtë:



Komentet e studentëve gjatë braktisjes së studimeve në Fakultetin Juridik:

- Arsye personale;
- Migrimi;
- Nuk mund ta gjej veten në drejtimin e Juridikut, lëndët janë të mira, por asnjëra prej tyre nuk i përshtatet mënyrës dhe sistemit tim të të mësuarit;
- Nuk mund t'i vazhdoj studimet sepse kam pauzuar disa vite;
- Nuk më pëlqen drejtimi;
- Jam zhvendosur në Prishtinë për të jetuar me ç'rast do vijoj studimet atje;
- Dëshiroj të ndërroj drejtimin;
- Pa arsye;
- Stafi i fakultetit është i mire, por nuk mund të përditësohem me ligjeratat për shkak të angazhimeve të tjera.

15. A13 – Vlerësimi ndërkolegial i orës mësimore

Vlerësimi ndërkolegial i orës mësimore realizohet dy herë në vit, çdo semestër. Vëzhgimi ndërkolegial bëhet në lëndën apo lëmin e njëjtë ose të përafërt.

Qëllimi i raportit është:

- Identifikimi i pjesëve e ligjëratis që e përmirësojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Sygjerimet lidhur me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Në fund të vëzhgimit shkruhet raporti i cili përmbledhë idetë dhe objektivat e procesit të vëzhgimit.

Në Fakultetin Juridik janë kryer pesë (5) vëzhgime ndërkolegiale për semestrin veror 2024/2025.

Vlerësimet e vëzhguesve mbi metodat dhe teknikat që ka përdorur mësimdhënësi:

- Metoda bashkëbiseduese dhe diskutimi ndërveprues, përmes të cilave studentët janë nxitur të marrin pjesë aktive në diskutimin e çështjeve që lidhen me procedurën penale.
- Ligjërimi shpjegues i shoqëruar me interpretime të dispozitave ligjore nga Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.
- Analiza e dokumenteve dhe dispozitave ligjore, duke përdorur legjislacionin si burim kryesor për trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve praktike.
- Analiza e rasteve praktike nga fusha e procedurës penale, me qëllim të lidhjes së koncepteve teorike me praktikën gjyqësore.
- Ushtrime praktike që kanë përfshirë hartimin dhe formulimin e parashtresave në procedurën penale nga ana e studentëve.
- Përdorimi i materialeve dhe parashtresave të ofruara në formë fizike për studentët, të cilat kanë ndihmuar në kuptimin më të mirë të përmbajtjes së njësisë mësimore.
- Kombinimi i shpjegimeve teorike me shembuj nga praktika gjyqësore, me qëllim të zhvillimit të aftësive analitike dhe praktike të studentëve.
- Metodot ndërvepruese të mësimdhënies, përmes të cilave është nxitur interaktiviteti dhe pjesëmarrja aktive e studentëve gjatë ligjëratis.
- Diskutim dhe bashkëbisedim me studentët, me qëllim të përmirësimit të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit.
- Përdorimi i shembujve konkretë nga praktika gjyqësore për të ilustruar dhe sqaruar çështjet juridike të trajtuara gjatë ligjërimit.
- Interpretimi juridik i normave dhe dispozitave ligjore përmes analizës së legjislacionit përkatës.
- Shpjegimi dhe interpretimi i dispozitave nga legjislacioni përkatës, duke u mbështetur në ligjin për procedurën civile/përmbartimore dhe në mjetet juridike për goditjen e vendimeve.
- Përdorimi i parashtresave dhe materialeve në formë fizike për studentët, me qëllim të lehtësimit të kuptimit të përmbajtjes së njësisë mësimore.

- Ndërlidhja e shpjegimeve teorike me praktikën gjyqësore, duke mundësuar kuptim më të plotë të materies nga ana e studentëve.

Vlerësimet e vëzhguesve mbi anët pozitive që i demonstronte profesori:

- Përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies, të cilat kanë kontribuar në zhvillimin e një procesi efektiv dhe të strukturuar të ligjërimit.
- Interpretimi i qartë i legjislacionit nga fusha e procedurës civile përmbartimore, i shoqëruar me shembuj dhe raste nga praktika.
- Përdorimi i parashtresave dhe materialeve praktike nga praktika gjyqësore, të cilat kanë ndihmuar studentët të kuptojnë më mirë zbatimin e dispozitave ligjore.
- Ofrimi i njohurive praktike për zhvillimin e procedurës gjyqësore në procedurën përmbartimore, veçanërisht në fazat që lidhen me goditjen e vendimeve gjyqësore.
- Zhvillimi i aftësive praktike të studentëve përmes ushtrimeve që përfshijnë hartimin e parashtresave procedurale, si prapësimi, ankesa dhe kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme.

Surgjerimet e vëzhguesve për mësimdhënësin e vëzhguar:

- Të vazhdohet me praktikën aktuale të zhvillimit të ligjërimit, e cila kontribuon në avancimin e mëtejshëm të metodave dhe metodologjive të mësimdhënies.
- Të vazhdohet me të njëjtin nivel cilësie në procesin e mësimdhënies dhe të ushtrimeve.
- Të vazhdohet me përdorimin e metodave aktuale të ligjërimit dhe ushtrimeve, të cilat janë vlerësuar si adekuate dhe efektive për trajtimin e njësive mësimore.
- Të vazhdohet me kombinimin e shpjegimeve teorike me shembuj dhe raste praktike, të cilat kanë kontribuar në kuptimin më të mirë të përmbajtjes mësimore nga ana e studentëve.

Në Fakultetin Juridik janë kryer dhjetë (10) vëzhgime ndërkolegiale për semestrin dimëror 2025/2026.

Vlerësimet e vëzhguesve mbi metodat dhe teknikat që ka përdorur mësimdhënësi:

- Metoda bashkëbiseduese (diskutimi i drejtuar), ku studentët janë nxitur të shprehin mendimet e tyre rreth nocionit të interpretimit dhe rëndësisë së tij në praktikën juridike.
- Parashtrimi i situatave konkrete juridike që kërkojnë interpretim të normave ligjore.
- Punë në grupe të vogla, ku studentët kanë analizuar raste ose dispozita ligjore dhe kanë identifikuar mjetet dhe llojet e interpretimit.
- Analiza e rasteve (case study), e cila ka ndihmuar studentët të lidhin teorinë me praktikën juridike.
- Pyetje-përgjigje, për të nxitur reflektimin, mendimin kritik dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve.

- Metoda e reflektimit, ku studentët kanë përmbledhur njohuritë e fituara dhe kanë nxjerrë përfundime mbi rolin e interpretimit të së drejtës.
- Metodatat ndervepruese të mesimdhënies, interaktivitet.
- Metoda interaktive dhe ajo vizuale. Studentët kanë treguar interesim për të fituar njohuri dhe për të parë krahasimin e sevituteve në të drejtën ndërkombëtare publike dhe në të drejtën civile.
- Analiza e rasteve konkrete nga gjykata speciale, prezantimi vizual dhe pyetje-përgjigjet nga studentët lidhur me gjykatën speciale.
- Paraqitja e shembujve për të elaboruar pozicionin politik dhe juridik të Kosovës në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Vlerësimet e vëzhguesve mbi anët pozitive që i demonstronte profesori:

- Komunikimi, interaktiviteti dhe liria e shprehjes së mendimit.
- Qartësia në shpjegim, komunikimi i hapur me studentët, nxitja e pjesëmarrjes aktive dhe lidhja e teorisë me praktikën.
- Trajtimi teorik i shoqëruar edhe me shembuj konkret si dhe interaktiviteti i studentëve të cilët shprehën njohuritë e gjeneruara nga ligjëratat paraprake.
- Përgatitje të lartë profesionale, njohuri të thelluara, komunikim të qartë, strukturim logjik të njësisë mësimore, ambient bashkëpunues, nxitja e diskutimit me studentë, si dhe lidhja e teorisë me shembuj praktikë, duke e bërë ligjëratën të kuptueshme dhe funksionale.
- Transparenca dhe gadishmëria për të iu përgjigjur çdo pyetje të parashtruar nga ana e studentëve sidomos qasja objektive dhe neutrale ndaj studentëve.
- Inkuadrimi i studentëve në ligjëratë përmes analizës së rasteve të studimit.
- Përgatitje e mirë profesionale dhe shkencore, qartësi në shpjegim, aftësi për të nxitur pjesëmarrjen aktive, qasja me studentin në qendër, përdorimi i shembujve praktik, komunikim etik dhe profesional, si dhe menaxhim i mirë i kohës dhe klasës.
- Strukturim i qartë i njësisë mësimore, shpjegim i kuptueshëm i përmbajtjes, komunikim efektiv dhe korrekt me studentët.
- Krijimi i ambientit pozitiv mësimor, ku studentët ndiheshin të lirë të shprehin mendimet dhe të parashtrajnë pyetje.
- Qasje bashkëkohore pedagogjike, me fokus te studenti dhe zhvillimi i mendimit kritik.

Surgjerimet e vëzhguesve për mesimdhënësin e vëzhguar:

- Të vazhdojë me qasjen interaktive dhe me studentin në qendër.
- Të ruajë qartësinë dhe profesionalizmin në shpjegim.
- Të vazhdojë në të njëjtën formë të lidhjes së teorisë me praktikën.
- Të vazhdojë të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të studentëve.
- Të vazhdojë përdorimin e metodave aktive të mesimdhënies me studentin në qendër dhe, në të njëjtën kohë dhe përdorimin e mjeteve didaktike bashkëkohore, veçanërisht përmes

përfshirjes më të shpeshtë të rasteve praktike dhe punës në grupe, me qëllim thellimin e të nxënit dhe rritjen e ndërveprimit në klasë.

- Përdorimi më i madh i shembujve praktikë, përfshirja e mëtejshme e studentëve në diskutime dhe shfrytëzimi i mjeteve vizuale për ta bërë mësimin edhe më të kuptueshëm.
- Të vazhdojë me aplikimin e metodave bashkëkohore të procesit të mësimdhënies.

Rekomandimet:

- Të rritet numri i vëzhgimeve ndërkolegiale i orëve mësimore, për të siguruar një vlerësim më të përgjithshëm dhe objektiv të procesit mësimor.

16. A14 – Vetëvlerësimi i mësimitdhënësve

Pyetësi për vetëvlerësimin e mësimitdhënësve realizohet 1 herë në vit nga stafi akademik i universitetit.




Pyetësi përmban 19 pyetje të mbyllura dhe 2 pyetje të hapura.

Qëllimi i pyetësit është identifikimi i anëve pozitive dhe përmirësimeve që duhet të bëhen. Pyetësi përfshin pyetje rreth potencialit të shfrytëzuar, respektimit të orarit dhe bashkëpunëtorëve, pritshmërive, kohës së dedikuar hulumtimeve, kontributit në komunitet/universitet, vlerësimit të studentëve, teknikave të mësimitdhënies, burimeve për ligjëratat, pjesëmarrjes në konferenca/trajnime, mentorimit, kontributit në zhvillim të kurrikulave, programit studimor etj.


Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mblidhura nga pyetësit.

Pyetësit i janë përgjigjur 9 respondentë, ku mesatarja totale e vetëvlerësimit të mësimitdhënësve në nivel fakulteti është 4.86% nga vlerësimi i përgjithshëm prej 5%


Rezultatet lidhur me vetëvlerësimin e mësimitdhënësve janë paraqitur si më poshtë:




3. Respektoj orarin dhe bashkëpunorët.




4. Puna ime i plotëson pritshmëritë e mia.




5. Vlerësimi i punës së studentëve është bërë në vazhdimësi.




6. Përdor teknika që e bëjnë të qartë qëllimin dhe përmbajtjen e ligjëratave dhe arrijen e objektivave të lëndës.




7. Ofroj detyra të cilat kërkojnë mendim analitik dhe kritik.




8. Përdor burime të ndryshme për ta pasuruar ligjëratën.




9. I kushtoj rëndësi ndërlidhjes të teorisë me praktikë.




10. I kushtoj kohë studentëve edhe pas ligjëratave.




11. Bashkëpunoj me kolegët për të identifikuar dhe zgjidh problemet e mësimdhënies dhe mësimnxënies.




12. Marr pjesë aktive në zhvillimin e kurrikulave.




13. Jam i përkushtuar në zhvillimin e hulumtimeve shkencore.




14. I përfshijë studentët në punë hulumtuese.




15. Prezantohet punime në konferenca, trajnime, kongrese, punëtori dhe i përdor njohuritë e reja në mësimdhënie.




16. Angazhohem në aplikimin e projekteve të reja.




17. Marr pjesë në mënyrë aktive në zhvillimin e njësive akademike.



18. Kontribuoj në universitet dhe komunitet, komisione, ligjërata dhe ekspertiza etj.



19. Sa kanë kontribuar hulumtimet e juaja, puna juaj, në zhvillimin e programit studimor, fakultetit dhe Universitetit?



Aspektet pozitive të evidentuara:

- Proceset menaxhuese të mësimdhënies dhe mësimnxënies, planifikimi dhe zhvillimi i Njesisë Akadematike;
- Zhvillimi i programeve dhe kurrikulave të reja, bashkëpunimi me studentë, aplikimi i njohurive të reja, si dhe realizimi i hulumtimeve shkencore;
- Hulumtime dhe bashkëpunimi me studentë në pjesën e hulumtimeve dhe projekteve të ndryshme;
- Bashkëpunimi me kolegët;
- Shkencë, hulumtime, ligjërime, si dhe në angazhime akademike në Universitet.

Fushat për përmirësim:

- Angazhimi në punime shkencore;
- Komunikim me institucionet relevante ndërkombëtare;
- Forcimi i lidhjes në mes punës teorike dhe asaj praktike, por institucionet nuk tregojnë vullnet të mjaftueshëm për një angazhim të tillë;
- Rritja e programave master në nivel fakulteti;
- Komunikimi me studentët.

Rekomandimet:

- Të përmirësohet cilësia akademike dhe institucionale përmes rritjes së angazhimit shkencor, forcimit të komunikimit ndërkombëtar dhe me studentët, lidhjes më të mirë të teorisë me praktikën, dhe zgjerimit të programeve master në nivel fakulteti.

17. A15 – Plani i zhvillimit profesional të mësimitdhënës/ asistentit

Pyetësi është i destinuar për stafin akademik dhe realizohet një (1) herë në vit.

Duke synuar sigurimin e cilësisë në procesin e mësimitdhënies dhe mësimitdhënies, universiteti është angazhuar të mbështesë zhvillimin profesional të të gjithë mësimitdhënësve dhe asistentëve përmes trajnimit dhe formimit, caktimit të detyrave që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive dhe fitimin e përvojës, krijimit dhe shkëmbimit të njohurive duke mësuar të tjerët dhe duke nxënë njëkohësisht.

Pyetësi përmban:

- Kërkesat e mësimitdhënësve dhe asistentëve për trajnim dhe mundësi për zhvillim profesional;
- Rekomandimet e Komisioni Qëndror për Sigurimin e Cilësisë për trajnim dhe zhvillim profesional në bazë të rezultateve të vlerësimit.

Pyetësit i janë përgjigjur njëmbëdhjetë (11) respondentë në nivel fakulteti.

Pyetësit i janë përgjigjur njëmbëdhjetë (11) respondentë në nivel fakulteti.

Fushat për zhvillim profesional (trajnimi ose zhvillimi i veçantë që kërkohet):

- Zhvillimi i moduleve të reja në QPM, nga fusha e metodologjisë së mësimitdhënies në kohët e përdorimit të IA-së.
- Pjesëmarrje në trajnime për metoda bashkëkohore të mësimitdhënies; trajnime për përdorimin e teknologjisë digjitale; përkrahje institucionale dhe financiare për publikime shkencore; mundësi për pjesëmarrje në shkëmbime akademike dhe programe mobiliteti (Erasmus+).
- Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare.
- Trajnime lidhur me aplikimin e programeve të avancuara në hartimin e rregulloreve apo të punimeve shkencore, por edhe në zbulimin e plagjiaturës me rastin e kontrollimit të seminareve apo punimin e temave të diplomimit në programin Bachelor apo Master.
- Trajnim për metodologjitë bashkëkohore të hulumtimit dhe mësimitdhënies.
- Pjesëmarrje në trajnime, seminare dhe konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare; thellimi i njohurive në fushat përkatëse të së drejtës dhe teknologjisë; përdorimi i mjeteve digjitale dhe platformave të reja mësimore; hartimi dhe publikimi i punimeve shkencore në revista të njohura; përfshirja e studentëve në projekte hulumtuese; bashkëpunimi me institucione akademike dhe kërkimore; bashkëpunim me institucione vendore dhe ndërkombëtare (universitete, organizata); pjesëmarrje aktive në komisione dhe aktivitete të fakultetit; kontribut në zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit (MoU); mentorim i studentëve në punime seminarike dhe hulumtuese; inkurajimi i të menduarit kritik dhe pjesëmarrjes aktive; organizimi i aktiviteteve ekstrakurrikulare dhe ligjëratave tematike.
- Trajner i QPM-së në nivel Universiteti.
- Fushat për zhvillim profesional përfshijnë nevojën për trajnime të specializuara në fushën e juridikut, të cilat do të kontribuonin drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimitdhënies dhe

avancimin profesional të stafit akademik. Konsideroj se këto trajnime duhet të organizohen nga ekspertë të jashtëm me përvojë dhe reputacion akademik, konkretisht nga profesorë të Universitetit të Prishtinës ose institucione të tjera relevante, e jo nga stafi i brendshëm i Universitetit të Prizrenit. Trajnimet e ofruara nga profesionistë të jashtëm sigurojnë qasje më objektive, përvoja të reja akademike dhe standarde më të larta profesionale. Konkretisht, trajnimi nga persona që ndodhen në të njëjtën pozitë apo institucion nuk e përmbush qëllimin e zhvillimit profesional, ndërsa angazhimi i ekspertëve të jashtëm do të ndikonte pozitivisht në cilësinë akademike dhe profesionale.

- Trajnime në mësimdhënie dhe mësimnxënie me metodat bashkëkohore, trajnime për hulumtime shkencore, mbështetje financiare për publikime shkencore.
- Pjesëmarrje në trajnime të organizuara nga ana e Universitetit.
- Metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënies në arsimin e lartë, me theks në të nxënies e orientuar nga studenti dhe të nxënies i bazuar në probleme, përdorimi efektiv i teknologjive digjitale dhe platformave elektronike në procesin mësimor dhe në vlerësimin e studentëve; po ashtu, zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe shkencore, përfshirë shkrimin akademik, publikimin në revista shkencore të indeksuara dhe respektimin e etikës së kërkimit shkencor janë prioritet; hartimi dhe zbatimi i metodave bashkëkohore të vlerësimit të rezultateve të të nxënies, forcimi i etikës akademike dhe integritetit profesional në mësimdhënie dhe kërkim shkencor është pjesë themelore e aktivitetit akademik shkencor në vazhdimësi.

Rekomandimet:

- Të zhvillohen programe të strukturuar të avancimit profesional për stafin akademik, duke përfshirë trajnime në metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe të hulumtimit, përdorimin e teknologjive digjitale dhe platformave mësimore, dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe shkëmbime ndërkombëtare - Erasmus+, ku një pjesë e trajnimeve të ofrohen nga ekspertë të jashtëm.

18. A16 – Gjurmimi i studentëve të diplomuar – ALUMNI

Pyetëtori është i destinuar për studentët të cilët i kanë përfunduar studimet.

Qëllimi i pyetëtorit është të identifikohet shkalla e punësimit të studentëve të diplomuar, fushën e punësimit, pra a janë të punësuar në fushën në të cilën i kanë përfunduar studimet, periudhën kohore të punësimit pas diplomimit si dhe sugjerimet e Alumnive për programin studimor.

Raporti për gjurmimin e studentëve të diplomuar-Alumni hatohet një herë në vit.

Shënim: Pyetëtori mbi gjurmimin e studentëve të diplomuar (ALUMNI) është i destinuar për të diplomuarit në nivel universitetit. Megjithatë, për shkak të mënyrës së strukturimit të tij, nuk është e mundur të identifikohen veçmas të diplomuarit e njëjstëve të caktuara akademike. Si rrjedhojë, në rastin konkret të Fakultetit Juridik është e vështirë të nxirren të dhëna specifike lidhur me shkallën e punësimit apo fushën e punësimit të të diplomuarve të këtij fakulteti.

Në nivel fakulteti, pyetëtori është plotësuar vetëm nga një respondent, gjë që e bën të pamundur nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse.

Rekomandimet:

- Të ndërmerren masa për rritjen e pjesëmarrjes së të diplomuarve në plotësimin e pyetëtorit.
- Fakulteti të forcojë bashkëpunimin me Zyrën e ALUMNI-t, duke organizuar takime periodike dhe duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me të diplomuarit, me qëllim identifikimin e shkallës së punësimit, fushën e punësimit, nëse janë punësuar në fushën ku i kanë përfunduar studimet, si dhe periudhën kohore të punësimit pas diplomimit.

19. A17 – Vlerësimi i praktikës profesionale të studentëve

Pyetëtori është i destinuar për studentët që kanë kryer punën praktike dhe realizohet një herë në vit. Pyetëtori përbëhet nga 6 kategori për vlerësim: Mësimi dhe Zhvillimi, Zhvillimi i Aftësive, Bashkëveprim dhe Bashkëpunim, Mbështetja e Mbikëqyrësit dhe Mentorit, Aplikimi i Njohurive Akademike, Kënaqësi e Përgjithshme dhe Rekomandime të cilat përfshijnë pyetje të mbyllura dhe të hapura.

Qëllimi i pyetëorit është marrja e informatave nga studentët lidhur me zbatimin e njohurive, aftësive në praktikë, sfidat si dhe kënaqshmërinë me mbikëqyrësin/mentorin..

Pyetëtori është plotësisht konfidencial dhe garanton anonimitet të plotë.

Shënim: Fakulteti Juridik aktualisht nuk e aplikon praktikën profesionale për studentët gjatë studimeve, dhe në mungesë të një përvoje të tillë praktike, nuk mund të nxirren të dhëna relevante apo të përgatitet një raport vlerësues lidhur me praktikën profesionale të studentëve.

Rekomandimet:

- Nuk ka



20. A18 – Vlerësimi i studentëve lidhur me Shërbimin e Këshillimit Akademik

Pyetësi është i destinuar për studentët që iu janë ofruar shërbimet e këshillimit akademik. Pyetësi përbëhet nga 7 pyetje për vlerësim, 6 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje e hapur.


Qëllimi i pyetësit është marrja e informatave nga studentët që i është ofruar këshillimit akademik lidhur me përmirësimin e tyre, arritjen e qëllimeve akademike dhe të karrierës pas ofrimit të këshillimit akademik.

Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetësi.


Pyetësit i janë përgjigjur 67 respondentë në nivel fakulteti, rezultatet e të cilit janë paraqitur në mënyrë grafike, si më poshtë:






2. Sa ju ka ndihmuar këshillimi akademik dhe sa është i dobishëm?



3. Si do t'i vlerësonit udhëzimet e dhëna nga këshilltarët akademik?







Komentet e studentëve rreth pyetjes 7: Në cilën fushë ju ka ndihmuar Këshillimi Akademik më së shumti (shëno):

- Këshillimi akademik më ka ndihmuar shumë në menaxhimin e stresit gjatë provimeve.
- Ka qenë i dobishëm në vlerësimin dhe kuptimin e mësimëve të ndryshme.
- Këshillimi ka ndihmuar në të gjitha fushat që lidhen me studimet dhe funksionimin e fakultetit, veçanërisht për studentët e vitit të parë.
- Mbështetja ka qenë e pranishme në të gjitha fushat akademike.
- Kam marrë ndihmë në rastet e caktuara kur kam pasur nevojë specifike.
- Këshillimi akademik ka qenë i vlefshëm për çdo shqetësim apo paqartësi, duke ofruar përgjigje dhe udhëzime të qarta për zgjidhjen e problemeve.
- Kam përfituar nga këshillimi juridik dhe administrativ për çështje akademike, përfshirë ligjëratat, provimet, dokumentacionin, procedurat e brendshme dhe nënshkrimet e profesorëve për paraqitjen e semestrit.
- Këshillimi ka qenë i dobishëm në orientimin akademik, zgjedhjen e lëndëve dhe planifikimin e studimeve, si dhe në planifikimin për të ardhmen.
- Më ka ndihmuar në sqarimin e çështjeve të ndryshme gjatë semestrit, përfshirë informimin mbi rregullat dhe procedurat e fakultetit.
- Këshillimi ka qenë i vlefshëm për njohjen me përdorimin e sistemit SMU, oraret, qasjen ndaj profesorëve dhe organizimin akademik.
- Kam marrë mbështetje në përgatitjen për provime dhe arritjen e rezultateve të suksesshme akademike.
- Këshillimi akademik ka qenë përgjithësisht i mirë dhe i dobishëm, megjithëse në disa raste mund të kishte qenë më i rregullt dhe më i qartë.
- Disa profesorë dhe studentë këshillues janë dalluar për korrektësi, gatishmëri dhe qasje pozitive, duke ndihmuar në sqarimin e pyetjeve dhe dilemave akademike.

- Këshillimi ka ndihmuar veçanërisht në informimin mbi rregullat dhe procedurat e provimeve.
- Kam marrë motivim dhe mbështetje morale gjatë studimeve.
- Në disa raste, studentët kanë deklaruar se nuk kanë përfituar shumë nga këshillimi akademik ose nuk kanë pasur nevojë specifike për të.

Rekomandimet:

- Të forcohet akoma edhe në shumë Shërbimi i Këshillimit Akademik për studentët, duke garantuar mbështetje të vazhdueshme për udhëzime në zgjedhjen e lëndëve, planifikimin e studimeve dhe zhvillimin profesional.

21. A19 – Vlerësimi nga punëdhënësit

Pyetëtori është i destinuar për punëdhënësit të cilët kanë punësuar të diplomuarit nga universiteti.

Pyetëtori përbëhet nga 7 pyetje për vlerësim, 6 pyetje të mbyllura dhe 1 pyetje e hapur.

Qëllimi i pyetëtorit është marrja e informatave nga punëdhënësit për të diplomuarit e punësuar lidhur me performancën dhe përgatitjen e tyre profesionale me qëllim të përmirësimit të cilësisë të arsimit universitar, përgatitjen më të mirë të studentëve për tregun e punës.

Raporti paraqet statistika të përgjithshme dhe rekomandime që dalin nga të dhënat e mbledhura nga pyetëtori.

Pyetëtori për vlerësimin e punëdhënësve mbi të diplomuarit e Fakultetit Juridik nuk është plotësuar nga asnjë prej punëdhënësve të kontaktuar. Si rezultat i mungesës së të dhënave, në këtë periudhë të vlerësimit, nuk ka qenë e mundur të përgatitet ndonjë raport apo analizë mbi vlerësimin e të diplomuarve nga ana e punëdhënësve.

Rekomandimet:

- Të rritet pjesëmarrja e punëdhënësve në vlerësimin e të diplomuarve, përmes komunikimit më të hershëm, nxitjes për përfshirje dhe ndjekjes së plotësimit të pyetëtorit, në mënyrë që të mund të nxirren të dhëna të besueshme dhe të përgatitet raport i qartë.